

Nr	Çështja	E gjetura	Rekomandimi	Komenti i NP "TERMOKOS" SH.A.	Zyrtari Pergjegjës	Data e Zbatimit	Statusi
1	Çështja A1 - Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes	Sipas SNK 16 Aktivet afatgjata materiale - rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet, nëse do të përdorej vlera drejtë në fund të periudhës raportuese. Procesi i vlerësimit të pasurive, për herë të fundit Kompania e kishte realizuar në vitin 2007. Si rezultat i kësaj në regjistrin kontabël të pasurive figurojnë 4,116 të tilla me kosto historike në shumën 6,495,840€, e që janë të zhvlerësuar në tërësi dhe vlera neto e tyre në libra ishte zero. Këto pasuri janë ende aktive dhe për to nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre, ashtu siç nuk ishte bërë edhe për pasuritë e tjera. Sipas konfirmimeve zyrtare, ndërmarrja gjatë vitit 2021 ka iniciuar procedurat e prokurimit si dhe ka nënshkruar kontratën për rivlerësim, i cili duhet të bëhet gjatë vitit 2022.	Bordi Drejtues të sigurojë që në përpunime me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, të bëhet rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes, me qëllim të prezantimit të vlerës së drejtë të tyre në Pasqyrat Financiare Vjetore.	Janë hartuar planet e menaxhimit të kontratës konformë standardeve të kerkuara. Procesi i rivlerësimit i pasurive të ndërmarrjes është perfunduar nga operatori ekonomik i cila ka pasur vonesë sipas menaxherit të kontratës dhe duhet të kordinohet me menaxherin e kontabilitetit për proceduarit e me tutje.	Departamenti Financiar	30.06.2023	Zbatimi ka filluar
2	Çështja A2 - Prezantimi jo i saktë i Rezervës së Rivlerësimit	SNK 16 – Aktivet afatgjata materiale: - paragrafi 39, përcakton që, nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohet tek kapitalet e veta me titullin tepriçë rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për aq sa kjo mbulon uljen e rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje. Po ashtu - paragrafi 40, përcakton, nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për aq sa kjo mbulon çdo tepriçë kreditore ekzistuese në tepriçen e rivlerësimit në lidhje me atë aktiv. Rënia që njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, zvogëlon shumën e akumuluar në kapital në zërin, tepriçë nga rivlerësimi. Shuma e rezervës së rivlerësimit e prezantuar në pasqyrat financiare ishte 10,435,031€, e cila është si rezultati i rritjes së aktiveve nga rivlerësimi në vitin 2007. Kjo shumë që nga viti 2007 nuk është korrigjuar në baza të rregullta, si rezultat i zhvlerësimit për pjesën e vlerës së rritur pas rivlerësimit. Si pasojë e kësaj, vlera e rezervës së rivlerësimit si dhe shpenzimet e zhvlerësimit nuk paraqesin gjendjen e tyre të saktë në pasqyrat financiare. Sipas konfirmimeve të zyrtarëve, mos korrigjimi i rezervës së rivlerësimit që nga rivlerësimi i fundit, ka ndodhur në mungesë të njohurive lidhur me kërkesat e standardeve për trajtimin e pjesës së rezervës së rivlerësimit.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, korrigjimin e rezervës së rivlerësimit si rezultat i zhvlerësimit të akumuluar sipas kërkesave të standardeve, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë.	Janë marrë parasysh dhe janë bërë kerkimet e duhura për korrigjime, duke tentuar që pika A2 të rregullohet gjatë procesit të A1.	Departamenti Financiar	30.03.2023	I pa zbatuar
3	Çështja A3 - Mungesa e dëshmime mbështetëse për pasuritë fikse	Bazuar në SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale, Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të njihen si aktiv nëse: është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri. Në kuadër të zërit kontabël "Pasuritë e Prekshme dhe të Paprekshme", i prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ekzistojnë 14 pasuri në vlerë 4,659,254€ për të cilat ndërmarrja nuk ka arritur t'i mbështes me dëshmi përkatëse. Përveç kësaj, gjendja e tyre e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar krahasuar me shënimet analitike të pasurive është mbivlerësuar për 156,144€. Sipas konfirmimeve të zyrtarëve, mungesa e dëshmime ishte si rezultat i vështirësive në pranimin e dokumentacionit gjatë procesit të pranimit të projekteve nga donacionet, si dhe mangësive në arkivimin e dokumentacionit të departamentit të financave, përdërisa diferencat, si rezultat i mos harmonizimeve të rregullta të pasurive.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që janë marrë veprimet e nevojshme për të siguruar evidencat që dëshmojnë vlerën e plotë të pasurive të regjistruara në sistemin kontabël, të cilat rrjedhimisht prezantohen edhe në pasqyrat financiare vjetore.	Ndërmarrja ka marrë veprime për të korrigjuar mirëpo ende nuk ka arritur të eliminojë të gjitha çështjet që reflektojnë. Duhet të kërkohej ne dokumentet e kontabilitetit si si janë regjistruar	Departamenti Financiar	28.02.2023	I pa zbatuar
4	Çështja A4 - Njohja e investimeve në vijim si pasuri në përdorim	Bazuar në SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale, Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të njihen si aktiv nëse: është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri. Gjithashtu një aktiv fillon të amortizohet kur është i disponueshëm për përdorim. Në kuadër të pasurive të prekshme dhe të paprekshme, ekzistojnë katër artikuj në vlerë prej 2,579,390€, të cilat janë regjistruar si pasuri në përdorim, përdërisa të njëjtat i takojnë Projektit për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit, i cili ishte investim në vijim. Si rezultat i kësaj ndërmarrja ka bërë zhvlerësimin e tyre në vlerë prej 56,232€ e cila ka rezultuar në nënvlerësim të vlerës së pasurive si dhe mbivlerësim të shpenzimeve të zhvlerësimit. Bazuar në konfirmimet e zyrtarëve, regjistrimi i investimeve në vijim si pasuri në përdorim ka ndodhur si shkak i mos njohjes së kërkesave të standardeve.	Bordi Drejtues të sigurojë, se të gjitha aktivet e prezantuara në pasqyrat financiare vjetore prezantojnë gjendjen e saktë të tyre si dhe zhvlerësimi i pasurive të bëhet vetëm kur aktivi është i disponueshëm për përdorim sipas kërkesave të standardeve.	Ndërmarrja ka marrë veprime për të korrigjuar , mirëpo ende nuk ka arritur të eliminojë të gjitha çështjet që reflektojnë. Duhet të kërkohej ne dokumentet e kontabilitetit ne kohen kur janë regjistruar ne menyre qe te prezantohen te auditori	Departamenti Financiar, Departamenti per investime kapitale	30.12.2023	I pa zbatuar
5	Çështja A5 - Prezantimi jo i saktë i Servituteve si dhe obligimeve që rrjedhin nga to	Kuadri Konceptual për Raportim Financiar: - paragrafi 4.44, specifikon se një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe kosto ose vlera e këtij aktivi mund të matet me besueshmëri. Ndërsa paragrafi 4.46, përcakton se një detyrim njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka gjasa që burime ekonomike do të dalin nga njësia ekonomike për të shlyer një detyrim aktual dhe shumën e të cilën do të shlyhet detyrimi mund të matet me besueshmëri. Investimet në vijim të prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk e prezantojnë gjendjen e saktë, pasi që në kuadër të saj janë prezantuar 764,645€ pasuri të cilat janë në përdorim (servitute të shpronësura gjatë projektit të ko-gjenerimit nga vlerësimi i parë). Përveç kësaj, ndërmarrja nuk ka regjistruar në shënime kontabël dhe prezantuar në pasqyrat financiare servitutet si dhe detyrimet e shpronësimit, nga vlerësimi i dytë dhe i tretë në vlerë prej 245,996€. Sipas konfirmimeve të zyrtarëve, mangësitë e lartpërmendura janë shkaktuar nga mungesa e informacioneve lidhur me kërkesat e standardeve, si dhe mungesës së qarkullimit të informacioneve në mes të departamenteve.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë regjistrimin e saktë të investimeve në vijim si dhe kalimin e tyre si pasuri në përdorim, vetëm kur plotësohen kushtet e njohjes sipas kërkesave të standardeve.	Janë marrë masa të duhura që regjistrimi i investimeve në vijim të bëhet sipas Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit.	Departamenti Financiar , Departamenti per investime kapitale	30.04.2023	I pa zbatuar

6	Cështja A6 - Mos prezantimi i saktë i gjendjes së stokut të mazutit në pasqyrat financiare	Kuai Konceptual për Raportim Financiar, paragrafi 4.44, specifikon se një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe kosto ose vlera e këtij aktivi mund të matet me besueshmëri. Vlera e prezantuar e "Stoqeve", në pasqyrën e pozicionit financiar nuk e prezanton vlerën e saktë të stoqeve të mazutit, pasi që shuma e stoqeve të prezantuara është më e lartë për 90,358€, krahasuar me dëshmitë mbështetëse të cilat prezantojnë sasinë e rezervave të mazutit në depo. Sipas konfirmimeve të zyrtarëve, diferenca e shkaktuar është si rezultat i shpenzimit të përdorimit të kaldajave gjatë vitit 2014, por që në mungesë të informacioneve në Departamentin e Financave, si dhe mos harmonizimit në baza vjetore nuk është regjistruar si shpenzim në kontabilitet.	Bordi Drejtues të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për të siguruar evidencat që dëshmojnë gjendjen e saktë të stoqeve, si dhe të bëhet harmonizimi i gjendjes së stokut me shënimet kontabël.	Ndermarrja është duke punuar në Rregulloren për Regjistrimin dhe Inventarizimin e Pasurive dhe Detyrimeve, përmes së cilës do të përcaktohen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve për barazimet në fundvit. Rrjedhimisht, do të bëhen barazimet e duhura të të gjitha stoqeve/aseteve (edhe këto egzistuese) dhe do të bëhet barazimi me Sistemin Informativ dhe do të paraqiten drejt në Pasqyrat Financiare	Departamenti Financiar, Departamenti i Prodhimit	Dhjetor - 2022	I pa zbatuar
7	Cështja A7 - Prezantimi jo i saktë të hyrave të shtyra nga grantet	Sipas SNK 20 - Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë. Për më tepër, grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet zhvlerësimi për ato mjete. "Obligimet – Të hyrat e shtyra nga grantet", të prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk e prezantojnë gjendjen e saktë, pasi që vlera e tyre në pasqyra financiare krahasuar me të dhënat analitike mbi bazën e të cilës bëhet zhvlerësimi, është nënvlerësuar për 65,828€. Për më tepër, nga mungesa e dëshmitë për 12 pasuri të fituara nga donacionet dhe atyre të fituara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, nuk kemi arritur të vërtetojmë të hyrat e shtyra në vlerë prej 4,613,739€ dhe të hyrat nga grantet të njohura nga zhvlerësimi i tyre në vlerë prej 439,709€. Sipas konfirmimeve të zyrtarëve, mungesat e informacioneve nga donatorët rreth investimeve të bëra si dhe mos organizimi adekuat i procesit të arkivimit, ka shkaktuar mungesën e dëshmitë si dhe informacioneve të cilat kanë rezultuar në regjistrim jo adekuat.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, regjistrimin e saktë të granteve me qëllim të prezantimit të saktë të të hyrave të shtyra dhe atyre të fituara nga zhvlerësimi, si dhe sigurimin e dëshmitë përkatëse për të gjitha pasuritë e financuara nga grantet.	Janë marrë masa të duhura që regjistrimi i granteve të bëhet sipas Standarteve Nderkombetare të Kontabilitetit.	Departamenti Financiar, Departamenti per investime kapitale	30.12.2022	Në proces
8	Cështja A8 - Mungesa e dëshmitë të llogarive të arkëtueshme si dhe mos barazimi i shënimet kontabël me të dhënat analitike	Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, pasqyra e pozicionit financiar duhet të prezantojë pozicionin financiar në datën raportimit, duke prezantuar gjendjen e aktiveve, detyrimit si dhe kapitalin neto, mbi bazën e të dhënave kontabël në po të njëjtën datë. Gjithashtu korniza konceptuale paragrafi 4.44 – Njohja e aktiveve, specifikon se një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe kosto ose vlera e këtij aktivi mund të matet me besueshmëri. Në bazën kontabël të llogarive të arkëtueshme, ndërmarrja ka një llogari me përshkrimin "Termokos", në vlerë prej 3,480,574€, mjete të cilat ndërmarrja nuk ka pretendime për përfitime në të ardhmen, si dhe nuk ka dëshmi mbështetëse të cilat masin me besueshmëri vlerën e tyre. Për më tepër, llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyra, në krahasim me shënimet analitike, ishin nënvlerësuar për 305,974€. Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, kjo ka ndodhur si pasojë e të metave teknike në softuerin e ndërmarrjes si dhe mos harmonizimeve të vazhdueshme të evidencave analitike të saldoeve të blerësve me shënimet kontabël.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që janë marrë veprimet korriguese te nevojshme për mbështetjen e llogarive të arkëtueshme me dëshmi mbështetëse. Po ashtu, të sigurojë harmonizimin e të dhënave analitike me të dhënat sintetike në sistemin kontabël.	Është nisur kërkimi për korrigjimin e shënimet kontabël, mirëpo ende ka nevojë për trajtimin e disa lëshimeve dhe të cilat duhet harmonizuar evidencat analitike të blerësve me shënimet kontabël.	Departamenti Financiar	30.06.2023	I pa zbatuar
10	Cështja A9 - Mos njohja e të hyrave shtesë për llogaritë e arkëtueshme të provizionuara	Nëse një borxh i provizionuar si i pa arkëtueshëm në një periudhë të kontabilitetit, arkëtohet në një periudhë të mëvonshme, shuma e arkëtuar duhet të regjistrohet si e ardhur shtesë në pasqyrën e të ardhurave në të cilën është arkëtuar pagesa, dhe njëkohësisht të zvogëlohet provizioni i ndarë për të njëjtën vlerë. Përkundër që ndërmarrja nuk kishte rregullore të provizionimit, për periudhën 2013-2020, në baza vjetore kishte ndarë provizion lidhur me llogaritë e arkëtueshme, mirëpo nuk ka informacione të plota lidhur me klientët e provizionuar që e përbëjnë vlerën 17,527,828€, të prezantuar në pasqyra me 31.12.2021. Si rezultat i kësaj, gjatë vitit 2021 ndërmarrja kishte arkëtuar mjete financiare nga klientët e provizionuar nga periudha 2013-2020, mirëpo të njëjtat nuk ishin njohur si e hyrë nga provizionet, e cila ka rezultuar në nënvlerësim të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme. Sipas konfirmimeve të zyrtarëve, mungesa e informacioneve lidhur me kërkesat e standardeve ka rezultuar në mos trajtimin e duhur të të hyrave shtesë nga arkëtimet prej këtyre llogarive.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë dëshmitë përkatëse lidhur me klientët e provizionuar, si dhe njohja e të hyrave nga arkëtimet e klientëve të provizionuar të bëhet sipas kërkesave të standardeve.	Ndërmarrja ka marrë veprimet për rishikim dhe korrigjim sipas standardeve të kërkuar.	Departamenti Financiar	30.12.2022	Në proces
12	Cështja A10 - Mospërpulthje në mes të shënimet kontabël të llogarive të arkëtueshme dhe të tërë konfirmimeve	Sipas Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmitë të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit, i cili duhet të barazohet me librat kontabël. Gjatë vitit 2021, NP "Termokos" nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjeve kontabël me të dhënat e konsumatorëve. Si rezultat i kësaj, në pesë raste shuma e borxhit e konfirmuar nëpërmjet konfirmimeve të jashtme ishte më e ulët për 541,673€ se shuma e borxhit në shënimet kontabël, dhe në një rast tjetër shuma e borxhit të konfirmuar ishte më e lartë për 46,380€. Në mungesë të konfirmimit nga ana e tyre, për dy klientë nuk kemi arritur të verifikojmë saktësinë e gjendjes së borxhit në vlerë prej 137,088€. Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, diferenca në konfirmime rezultojnë nga kontestet gjyqësore me disa klientë, mbylljes së një subjekti, kontestit për pronësi si dhe titullarin e borxhit, si dhe në një rast për shkak të mos harmonizimit të vazhdueshëm me klientë.	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave kontabël të llogarive të arkëtueshme dhe klientëve të saj në baza periodike, në mënyrë që të konfirmohet vlera saktë e llogarive e pranuar nga dy palët.	Ndërmarrja do të marrë veprime konkrete për harmonizimin e të dhënave kontabël me llogaritë e klienteve dhe se paku një here në vit do të bëjë vlerësimin e pasurisë dhe detyrimeve.	Departamenti Financiar, Departamenti i Furnizimit	31.12.2023	I pa zbatuar

13	Cëshja A11 - Prezantimi i llogarive të arkëtueshme të pidentifikuara	Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, pasqyra e pozicionit financiar duhet të prezantoj pozicionin financiar në datën raportimit, duke prezantuar gjendjen e aktiveve, detyrimit si dhe kapitalin neto, mbi bazën e të dhënave kontabël në po të njëjtën datë. Gjatë auditimit kemi vërejtur se arkëtimet në shumën prej 57,969€, prej të cilave 13,443€ në vitin 2021, nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes, mirëpo ishin regjistruar në zërin kontabël me përshkrimin "Llogaritë e arkëtueshme të pidentifikuara – Konto Kalimtare". Sipas zyrtarëve përgjegjës, ky ishte problem i bartur që nga viti 2013 si pasojë e vështirësive në identifikimin e konsumatorëve përmes llogarisë bankare të ndërmarrjes, për shkak të përshkrimit jo të plotë të të dhënave me rastin e pagesave.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar konsumatorët të cilët i kanë kryer pagesat e grumbulluara në llogarinë "Llogaritë e arkëtueshme të pidentifikuara – Konto Kalimtare" dhe se klientëve të identifikuar, u janë zbritur obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes.	Me integrimin e projektit të MCC parashihet që avansimi i sistemit softverik dhe automatizimit të pagesave, një herit është bere çësja ne banka permes ebankig per infomata me te detajuara.	Departamenti Financiar	31.03.2023	I pa zbatuar
14	Cëshja A12 - Prezantimi jo i saktë i obligimeve në pasqyrat vjetore financiare	Sipas Kuartrit Konceptual për Raportim Financiar (paragrafi 4.46) një detyrimi njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka gjasa që burime ekonomike do të dalin nga njësia ekonomike për të shlyer një detyrim aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet detyrimi mund të matet me besueshmëri. Për më tepër, sipas Ligji Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, kërkohet që Shoqëritë tregtare, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmi të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Llogaritë e pagueshme tregtare të prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk prezantojnë gjendjen e tyre të saktë. Në dy raste ekzistojnë mospërputhje në mes shënimeve kontabël dhe gjendjes së furnitorëve, duke prezantuar vlerë më të ulët për shumën 177,190€ se sa vlera e konfirmuar nga furnitori, shumë e cila është kontestuar nga ndërmarrja, por për të njëjtën nuk është iniciuar ndonjë pretendim gjyqësor. Përveç kësaj, ndërmarrja nuk ka trajtuar ekzistencën dhe vlerësimin e detyrimeve nëpërmjet procesit të inventarizimit gjatë vitit 2021. Sipas shpjegimeve të zyrtarëve përgjegjës, mospërputhjet e detyrimeve me konfirmimet e furnitorëve ekzistojnë se janë borxhe të shkaktuara nga gabimet në matësit e energjisë së furnitorit.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për të zgjedhur problemin lidhur me shumën e borxhit të kontestuar. Veç kësaj, regjistri i obligimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.	Ndërmarrja ka kushtuar gjithnjë vëmendje të posaqme ndaj detyrimeve të saj. Faturimet e njëanshme nga ana e furnitorëve mund të paraqesin probleme edhe në të ardhmen. Gjithsesi, ndërmarrja do të përkushtohet që transaksionet e tilla të elimonohet dhe të bëjë të gjitha barazimet në mes ndërmarrjes dhe furnitorëve (dhe detyrimeve të tjera).	Departamenti Financiar	Dhjetor - 2022	Në proces
15	Cëshja A13 - Mos prezantimi i saktë i provizioneve	Sipas SNK 37 - Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara, provizionet duhet të njihen nëse njësia ekonomike ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) që është rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, kur ka mundësi që për shlyerjen e detyrimit të kërkohet një dalje e parave, që përfshijnë përfitime ekonomike dhe mund të bëhet një gruarje e besueshme për shumën e detyrimit. Për më tepër, kur ka më shumë mundësi se sa jo që një detyrim aktual të ekzistojë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, njësia ekonomike njih një provizion, në të kundërtën kur mundësia e daljes së parave për shlyerje është e pakët njësia ekonomike duhet të jep informacione shpjeguese. Ndërmarrja nuk kishte evidentuar të gjitha detyrimet të cilat lindin si rezultat i vendimeve përfundimtare të gjykatës apo mundësisë së lartë të ndodhjes së detyrimit për shkak të kontesteve të hapura gjyqësore. Si rrjedhojë e kësaj, provizionet e prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar ishin nënvlerësuar për 81,703€. Mos prezantimi i saktë i provizioneve ka ndodhur për shkak të mungesës së këmbimit të informacioneve në mes të departamenteve, lidhur me statutin e lëndëve gjyqësore.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë krijimin e procedurave apo rregulloreve adekuate që do të mundësonin që në baza vjetore të bëhet vlerësimi i provizioneve, në mënyrë që prezantimi i llogarive të jetë sa më i qartë.	Gjatë vitit 2022 ndërmarrja do të bëjë vlerësim për të gjitha rastet gjyqësore, me ç'rast do të evidentohen të gjitha gabimet eventuale (të pa-regjistruara) dhe do të bëhet korrigjimi i tyre.	Departamenti Financiar, Departamenti Ligjor	Dhjetor - 2022	I pa zbatuar
16	Cëshja A14 - Prezantimi jo i drejtë i pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet	Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, një pako e pasqyrave financiare, duhet të përmbajë edhe një pasqyrë të ndryshimeve në ekuitet, e cila paraqet një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve në ekuitet. Çështjet e ngritura brenda këtij kapitulli, në lidhje me rezervën e rivlerësimit, të hyrat dhe shpenzimet e zhvlerësimit të cilat kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave, kanë efekt gjithashtu edhe në pasqyrën të pasaktë të fitimit të periudhës të bartur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet. Shkak për mos prezantimin e saktë të pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet ishin mos prezantimi i saktë i zërave të cilat kanë ndikim edhe në këtë pasqyrë.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në mos prezantimin e saktë të pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet dhe të marrë veprimet nevojshme korrigjuese për të pasur një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.	Do të merrren hapa konkret per prezentimin e sakte te pasqyres se ndryshimit ne ekuitet ku korigjimet do te behen konform standarteve nnderkombetare te kontabilitetit.	Departamenti Financiar	Dhjetor - 2023	I pa zbatuar
17	Cëshja A15 - Mos prezantimi i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë	Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, një njësia ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat financiare të saj, me përjashtim të informacionit mbi rrjedhën e parasë, mbi bazën e kontabilitetit rritës. Qëllimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë, sipas SNK 7, është për të plotësuar nevojat e përdoruesve të informacionit kontabël në lidhje me rezultatin monetar, me fluksin e lëvizjes së mjeteve monetare gjatë një periudhe kontabël. Bazuar në çështjet e ngritura për zërat kontabël si: pasuritë, të arkëtueshmet, të pagueshmet, stoqet dhe zhvlerësimi, zëra të aktiviteve operative dhe investuese të rrjedhës së parasë, konkluzioni ynë është se rrjedha e parasë nuk prezanton një informacion të saktë. Shkak për mos prezantimin e saktë të pasqyrës së rrjedhës së parasë ishin mos prezantimi i saktë i zërave të cilat kanë ndikim edhe në këtë pasqyrë.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në mos prezantimin e saktë të rrjedhës së parasë dhe të marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për të pasur një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.	Janë marrë parasysht dhe janë bërë kerkimet e duhura për analizimin e te gjitha zerave qe ndikojn ne rrjedhen e parase	Departamenti Financiar	Dhjetor - 2023	Në proces

18	Çështja A16 - Mos prezantimi i informacioneve të plota në shënime shpjeguese	<p>Sipas SNK 1 – Paraqitja e pasqyrave financiare, një element i pandarë i pasqyrave financiare janë shënime shpjeguese të tyre. Sipas përcaktimeve të bëra në këtë standard këto shënime të pasqyrave financiare duhet të paraqesin informacion në lidhje me bazat e përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare si dhe në lidhje me politikat kontabël të zgjedhura dhe të aplikuar për ngjarjet dhe veprimet më të rëndësishme, sqarojnë informacionin e kërkuar nga SNK, japin informacione shtesë i cili nuk është paraqitur në pasqyrat financiare, por i cili është i nevojshëm për një paraqitje të drejtë të tyre. Në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare mungonin informata të rëndësishme të cilat janë në kundërshtim me kriterin e lartpërmendur si dhe kriteret përkatëse të paraqitura në vijim: - Te zëri "Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera" nuk janë prezantuar detajet e përbërjes së zërit, duke përfshirë edhe mos shpalosjen e shënimeve për shumën e provizionuar të llogarive të arkëtueshme. Për më tepër, në këtë zë të pasqyrave, nuk janë prezantuar në shpalosje edhe avancet për tatime në vlerë 84,170€; - Te zëri "Paraja dhe ekuivalentet e parasë", shënime shpjeguese nuk prezantojnë detajet e përbërjes së zërit; - Sipas SNK 20 - Grantet qeveritare, duhet të ofrojnë informacione shpjeguese për politikat kontabël të përdorura për grantet, natyrën dhe madhësinë e granteve qeveritare të njohura në pasqyrat financiare, dhe kushtet e paplotësuara të lidhura me ndihmën qeveritare. Kompania nuk kishte dhënë asnjë informacion specifik në lidhje me kushtet si dhe nuk ishin shpalosur informacione lidhur me përbërjen e kësaj shume. – Sipas SNK 37 – Ndërmarrja në pasqyrat e saj duhet të shpalosë shënime lidhur me detajet e provizioneve të njohur si detyrime aktuale si dhe detajet për detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara. Kompania nuk kishte dhënë informacione lidhur me detajet e shumës së njohur si provizione, përderisa nuk ka prezantuar detyrime dhe aktive tjera të kushtëzuara. - Ekuiteti në shënime shpjeguese nuk ka prezantuar fitimet e akumuluar të prezantuara në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet në vlerë prej 4,949,311€. Për më tepër, rezerva e rivlerësimit është theksuar se zvogëlohet çdo vit për pjesën e zhvlerësimit të pasurive të rivlerësuara, veprim i cili nuk është aplikuar nga ndërmarrja; Përveç kësaj, si rrjedhojë e mangësive të cilat janë identifikuar dhe prezantuar tek baza për opinionin, për zërat: llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, pasuritë, të hyrat e shtyra, stoqet, shpenzimet dhe të hyrat, shënime shpjeguese të dhëna për të njëjtat nuk japin informacione të plota dhe të sakta për përdoruesit e tyre. Mos prezantimet e sakta dhe te plota të shënimeve shpjeguese të pasqyrave, ka ndodhur në mungesë të njohurive të zyrtarëve financiar lidhur me kërkesat e standardeve.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që shënime shpjeguese të sigurojë që pasqyrave të përgjithshme, të përbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe të sigurojnë se informacionet mbi përbajtjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Gjatë përpilimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2022 ndërmarrja do të bëjë shpalosjen e informatave sipas kriterëve të kërkuara nga Standardet relevante	Departamenti Financiar	Dhjetor - 2022	I pa zbatuar
	Çështja B1 - Mungesa e rregulloreve si dhe mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme	<p>Sipas SNRF 9 - Instrumentet Financiare, kërkohet që Kompania të vlerësojë provizion të humbjeve bazuar në vjetërsinë e bilancit të llogarive të arkëtueshme dhe përvojën historike të shlyerjes, vlefshmërinë e kreditorëve të klientit dhe ndryshimet në kushtet e pagesës së klientit. Ndërmarrja nuk posedon një rregullore apo procedurë që specifikon mënyrën e provizionimit të llogarive të arkëtueshme sipas kërkesave të standardit. Si rezultat i kësaj, zëri i llogarive të arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerë prej 4,274,654€, për vitin 2021 nuk është vlerësuar për provizionim të humbjeve bazuar në vjetërsinë e llogarive, e rrjedhimisht nuk është njohur as lejimi i humbjes së bilancit të llogarive të arkëtueshme.</p>	Bordi i Drejtorëve të hartojë dhe aprovon një rregullore për provizionimin e llogarive të arkëtueshme, në mënyrë që periodikisht me rastin e hartimit të pasqyrave financiare të vlerësojë llogaritë e arkëtueshme për provizionim sipas kërkesave të standardeve.		Bordi / Menaxhmenti		
	Çështja B2 - Prezantimi i llogarisë së arkëtueshme si borxh i ngrirë	<p>Bazuar në Kuadrin Konceptual për Raportim Financiar paragrafi 4.44 – Njohja e aktiveve, specifikon se një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe kosto ose vlera e këtij aktivi mund të matet me besueshmëri. Në kuadrin të zërit "Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera", ndërmarrja ka të prezantuar një llogar të arkëtueshme me emërtimin "Borxh i ngrirë" në vlerë prej 385,004€, e cila ishte rezultat i një vendimi të Bordit dhe aksionarëve të ndërmarrjes për ngrirjen e pjeshme të borxheve. Megjithatë, ndërmarrja për këtë vlerë nuk ka pretendime për përfitime në të ardhmen apo dëshmi mbështetëse për njohjen si llogari e arkëtueshme.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet korrigjuese të nevojshme, në mënyrë që informacioni i llogarive të arkëtueshme si dhe prezantimi i tyre në pasqyrat financiare të jetë i saktë dhe i drejtë.		Aksionaret		
19	Çështja A17 - Vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare	<p>Neni 31.3 i Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton: "Brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e NP-së, në përputhje me Nenin 14.1, do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektiviteti dhe përgjithshme në realizimin e çaqeve të vendosura në Planin e Biznesit. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e shihet të arsyeshme ta miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këllirë vjetor (i) Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, e cila e publikon atë në faqen e saj zyrtare në internet dhe (ii), sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit (eve) Komunal të Aksionarëve. Bordi i NP-së po ashtu do të publikojë raportet vjetore në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP". Kompania nuk ka finalizuar pasqyrat financiare për vitin 2021, deri me datën 22.04.2022, kur edhe është bërë aprovimi i tyre nga Bordi Drejtues, edhe përkundër kërkesave ligjore që të njëjtat të jenë të nënshtruara dhe aprovuara me datë 15 mars 2022. Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare, kanë ndodhur si rezultat i mungësës së informacioneve mbi kërkesat ligjore.</p>	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur, aprovuar dhe publikuar në afatet e paracaktuara ligjore.	Aprovimi i pasqyrave nga bordi është bere sipas afateve te kerkuara, por gjate auditimi është kerkuar qe pasyrat duhet te aprovohen pasi te certifikohen nga nga Kontablisti i Certifikuar. Ne vitet ne vijim menaxhmenti ne kordinim me Bordin e drejtorëve do te merre gjitha masat e nevojshme qe pasqyrat financiare te pergaditen dhe aprovohen sipas afateve te percaktuara ligjore.	Departamenti Financiar	10.02.2023	Zbatimi ka filluar

20	Cështja A18 - Mungesa e kontratave me konsumatorë	Bazuar në Rregulloren për kushtet e përgjithshme të furnizimit me Energji (Rregulla ZRRE/Nr. 12/2017), neni 6 - Furnizimi me energji termike, paragrafi 3, nën paragrafi 3.4 "Në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të: paguajnë për energjinë termike të shpenzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji Termike të lidhur me Furnizuesin, si dhe sipas tarifave të miratuara nga Rregullatori". Sipas regjistrimit të konsumatorëve, ndërmarrja ka 15,779 konsumatorë aktiv, ndërkaq posedon kontrata vetëm me 3,756 prej tyre apo 24%. Nga ekzaminimi i mostrave të të hyrave, 35 raste kanë rezultuar se nuk kanë kontratë për furnizim me energji termike, ndërkaq 32 kanë kontratë të lidhur gjatë vitit 2005-2008, por që specifikat e matjeve si dhe çmimet nuk përputhen me mënyrën dhe tarifat aktuale të faturimit të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Tri kontrata janë lidhur rishtazi. Sipas konfirmimeve zyrtare, mungesa e kontratave ka ndodhur për shkak të refuzimit të klientëve për të nënshkruar kontratën dhe pamundësisë së imponimit të tyre për nënshkrim.	Kryesuesi i Bordit të sigurojë, që të gjithë klientët të cilët përfitojnë shërbime nga ndërmarrja, të kenë të lidhur kontratën për furnizim me energji termike sipas rregullave të ZRRE-së.	Gjat implementimit të projektit të MCC për vendosjen e matesve të energjisë të konsumatorët individual do të nënshkruajn edhe kontratat e reja për shfrytëzimin e energjisë ngrohese.	Departamenti Furnizimi, Departamenti Ligjor	Gusht 2022 deri Tetor 2023	Në proces
21	Cështja B3 - Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit të pasurive dhe stoqeve me regjistrat kontabël	Sipas Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmi mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare dhe duhet të barozohet me librat kontabël. Kompania nuk kishte bërë harmonizimin në mes të: - regjistrimit të pasurive dhe raportit të komisionit për inventarizim, dhe si rezultat i kësaj nuk ka arritur të verifikoj ekzistencën dhe gjendjen e pasurive për vlerën e tyre 38,901,057€ të raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar; dhe - regjistrimit të stoqeve dhe raportit të komisionit për inventarizim e tyre, dhe si rezultat i kësaj ndërmarrja nuk ka arritur të verifikoj ekzistencën dhe gjendjen e stoqeve për vlerën e tyre 999,609€ të raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar. Sipas konfirmimit të zyrtarëve, mos harmonizimi kishte ndodhur për shkak të vonesave në procesin e inventarizimit vjetor.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që procesi i inventarizimit të bëhet në mënyrë të rregullt dhe para dorëzimit të pasqyrave financiare, në mënyrë që rezultatet e regjistrimeve të fundvitit të harmonizohen me regjistrat kontabël dhe diferencat eventuale të reflektohen edhe në pasqyra financiare.	Ndërmarrja para procesit të formimit të komisionit për inventarizim do të marr hapa të nevojshme për sinkronizimin me të dhenat kontabël.	Departamenti Financiar, Komisioni Qendror	31.12.2022	I pa zbatuar
22	Cështja B4 - Mungesa e emërimit të konsumatorëve	Sipas Ligjit Nr. 05/L-052 për energjinë termike, neni 20 dhe 25 kërkohet që furnizuesit publik të lidhin kontratë me konsumatorët në pajtim me rregullat e nxjerra nga ZRRE, për të gjithë konsumatorët të cilët i plotësojnë kushtet, përfshirë edhe identitetin e pronarit apo të autorizuarit i cili shfrytëzon energjinë termike. Në regjistrin e konsumatorëve, prej tyre janë të regjistruar 28 konsumatorë me përshkrimin "NN" (simbole që nuk përkohet me emërtime të personave fizik apo juridik) dhe shuma që këta konsumatorë i detyrohen kompanisë me 31.12.2021 është 53,553€, përderisa regjistrimi i konsumatorëve pa përshkrim të emrit të tyre krijon vështirësi në identifikimin e tyre. Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, mos emërimi i konsumatorëve ka ndodhur si shkak i pamundësisë së identifikimit dhe kontaktimit të tyre.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që brenda një afati të përcaktuar kohor të shqyrtojë dhe të marrë masat përmirësuese, në mënyrë që të gjithë konsumatorët të regjistrohen si shfrytëzuesve të shërbimeve me të gjitha të dhënat e kërkuara.	Prej këtyre 28 konsumatoreve të rëxhstruar me NN janë identifikuar 13 konsumatore, kan mbetur per verifikim edhe 15 konsumatore, ky verifikim do te vazhdoje te kryhet edhe me projektin e MCC gjat vendosjes se matesve te energjise.	Departamenti i Furnizimit	Prill-2022 deri tetor 2023	Zbatimi ka filluar
23	Cështja A19 - Mos prezantimi i saktë i gjendjes së parave të gatshme në bankë dhe arkë	Kuadri Konceptual për Raportim Financiar paragrafi 4.44, specifikon se një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe kosto ose vlera e këtij aktivi mund të matet me besueshmëri. Zëri kontabël "Paraja në arkë dhe bankë", i prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar nuk e prezanton saktë gjendjen e tij, pasi që ndërmarrja vlerën 2,952€ të mbajtur si para në arkë dhe konto kalimtare, nuk ka arritur ta mbështes me dëshmi përkatëse, përderisa shuma e parave të konfirmuara nëpërmjet letër konfirmimeve nga tri institucione financiare, ishte më e ulët për 1,712€ se shuma e prezantuar në shënimet kontabël. Sipas konfirmimeve të zyrtarëve, diferencat e parave të gatshme krahasuar me gjendjen e prezantuar pasqyrojnë gabime të bartura nga vitet paraprake, si dhe mos harmonizimet e rregullta me mbajtësit e parave.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për të siguruar evidencat që dëshmojnë gjendjen e parave të gatshme, si dhe të bëhet harmonizimi i gjendjes së parave në llogari me gjendjen kontabël.	Cështja e parasë pezull ka të bëjë me paranë e shpërndarë të arkatarët e Ndërmarrjes dhe Furnizuesi. Departamenti Financiar do të bëjë shpërndarjen e tyre edhe në sistemin informativ sipas ndarjes së mësipërme.	Departamenti Financiar	Shtator - 2022	I pa zbatuar
24	Cështja A20 - Mos prezantimi i llogarive të arkëtueshme negative si të hyra të shtyra	Sipas SNK 1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas parimit akrual. Sipas këtij parimi, të hyrat e shtyra janë të hyra të arkëtuara në avancë, dhe paraqesin detyrime që ka ndërmarrja për të kryer shërbime në të ardhmen, për shkak të shumave monetare të arkëtuara paraprakisht prej ndërmarrjes. Kështu që, në momentin e marrjes së këtyre mjeteve monetare, duke zbatuar parimin e përputhjes së të ardhurave me shpenzimet e kryera për to, ndërmarrja nuk i njeh këto arkëtime si të hyra, pasi shërbimi për to ende nuk është kryer. Pra, shtynë njohjen e këtyre të hyrave dhe si pasojë ato do të njihen si detyrime. Arkëtimet në avans nga klientët e saj, që kishin parapaguar për shërbimet e energjisë termike në shumën 27,056€, ndërmarrja nuk i ka njohur si të hyra të shtyra - detyrime, por për këtë shumë kishte zvogëluar totalin e llogarive të arkëtueshme. Veprimet e tilla kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë për trajtimin e çështjeve në përputhje me standardet e kontabilitetit.	Bordi i drejtorëve të sigurojë që zyrtarët financiar, regjistrimin e parapagimeve që japin efekt në disa periudha kontabël, ta bëjnë bazuar në parimin akrual duke siguruar që të hyrat e shtyra ekonomiksht maturohen (realizohen) edhe në periudhat e ardhshme kontabël.	Janë marrë masa të duhura që regjistrimet në vijim të bëhet sipas Standarteve Nderkombetare të Kontabilitetit.	Departamenti Financiar	31.12.2022	Në proces

25	Çështja A21 - Specifikimet teknike me përshkrim të emrit të prodhuesit	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për procedurat e prokurimit, neni 20.8, gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike si rregullat përgjithshme është e ndaluar që të referohen në një prodhim specifik, marka tregtare, patenta apo edhe origjina specifike të prodhimeve. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët "ose e barasvlershme/ekuivalente". Te kontrata "Furnizim me pjesë rezervë të pompës qarkulluese KSB, ETANOR dhe MULTITEC" në vlerë 118,89€e, kompania gjatë përgatitjes së kërkesave në dosje të tenderit përkatësisht tek specifikimet teknike, kishte kërkuar përshkrimin e produkteve me emrin e prodhuesit. Kjo ka ndodhur për shkak se gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike, zyrtarët nuk kanë qenë në	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që specifikimet teknike në dosje të tenderit të bëhen sipas kërkesave ligjore për të shmangur mundësinë e favorizimit të prodhuesve të caktuar gjatë procesit të prokurimit.	Zyra e Prokurimit ka pranuar kërkesë, nga Departamenti i Prodhimit /Kogjenerimit me titull : Furnizim me pjesë reserve te pompes qarkulluese KSB ,ETANOR dhe MULTITEC Të aporvuar nga të gjithë personat përgjegjës të ndermarrjes , ne nuk kemi pas njohuri, për KSB ,ETANOR dhe MULTITEC se ky emer është brend pasi që me profesion nuk jemi inzhinier të fushës për këte te gjetur kemi kerkuar sqarim nga Departamentit te Prodhimit/Kogjenerimit konkretisht nga Zyrtari kërkuës , pasi që përveq titullit: Furnizim me pjesë reserve te pompes qarkulluese KSB ,ETANOR dhe MULTITEC është cekur edhe në specifikacion teknikë (KSB ,ETANOR dhe	Departamenti i Prokurimit		Zbatimi ka filluar
26	Çështja A22 - Mos prezantimi i saktë i parapagimeve	Sipas SNK 1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas parimit akrual. Sipas këtij parimi, parapagimet janë shuma të paguara në avancë, dhe paraqesin pasuri që ka ndërmarrja për përvehtësimin e një pasurie apo kryerjen e një shpenzimi në të ardhmen, për shkak të shumave të paguara paraprakisht nga ndërmarrja. Kështu që, në momentin e pagesës së këtyre mjeteve monetare, duke zbatuar parimin e përputhjes se pagesave me të mirat e marra nga to, ndërmarrja nuk i njeh këto pagesa si shpenzime apo pasuri, pasi që ende nuk janë kryer. Pra, shtynë njohjen e tyre si shpenzime/pasuri dhe si pasojë ato do të njihen si parapagime. Gjatë testeimeve tona, kemi vërejtur që parapagimet ndaj furnitorëve për shërbimet/furnizimet e marra në shumën 3,16€, nuk janë njohur si parapagime – pasuri, por për këtë shumë ishte zvogëluar totali i llogarive të pagueshme. Veprimet e tilla kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë për trajtimin e çështjeve në përputhje me standardet e kontabilitetit.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që në datën e hartimit të pasqyrave financiare të prezantohen parapagimet që lindin nga veprimet rregulluese për to, si dhe janë marrë masat e nevojshme korrigjuese për të pasur një prezantim të drejtë të parapagimeve.	Kjo çështje është rregulluar.	Departamenti Financiar	28.02.2022	I zbatuar
27	Çështja A23 - Mungesa e rregullores së shpenzimeve për procedurim të pagesave	Sipas Nenit 34.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike "Të gjitha NP do t'i përgatisin dhe vënë në fuqi rregulloret të cilat kërkojnë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare" si dhe Nenit 27, pika 27.1 të Statutit të Ndërmarrjes Publike NH "Termokos" Prishtinë (Sh.a.), "kompania duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e kompanisë". Kompania nuk ka të hartuar dhe miratuar rregullore apo udhëzues për administrimin dhe funksionimin e procesit të shpenzimeve dhe furnizimeve, sipas kërkesave ligjore. Mungesa e rregullores ka ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk e kishte konsideruar si të nevojshme aprovimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e proceseve.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë hartimin dhe miratimin e një rregullore për menaxhimin e shpenzimeve dhe furnizimeve, duke i bërë të qarta përgjegjësitë e zyrtarëve, procedurat e pranimit të furnizimeve, format, dëshmitë, nivelet e kontrollit të brendshëm dhe periudhat e raportimit të tyre.		Bordi / Menaxhmenti		
28	Çështja A24 - Angazhimi i punëtorëve me kontratë për punë dhe detyra specifike pa zhvillim të procedurave të rekrutimit	Sipas Ligjit të punës nr.03/L-212 neni 8, punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpallë konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Kompania gjatë vitit 2021, ka angazhuar katër punonjës me kontratë me afat të caktuar për punë dhe detyra specifike, mirëpo këta punonjës mbulonin pozitat e rregullta të punës dhe për të njëjtit nuk kishte zhvilluar procedura të rekrutimit Sipas menaxhmentit të ndërmarrjes, punësimi përmes kontratave për punë dhe detyra specifike ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së kërkesave të njëjësive brenda kompanisë.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që me rastin e themelimit të marrëdhënieve të punës të zhvilloj procese të rekrutimit në mënyrë të rregullt dhe transparente dhe të sigurojë se pozitat e rregullta mbulohe me kontrata të rregullta të punës.	Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur asnjë rast të angazhuar për punë dhe detyra specifike	D. Administrativ	01.01.2022	I zbatuar
29	Çështja A25 - Mos përfshirja e shpenzimeve të sigurimit të punëtorëve në të ardhurat bruto	Sipas Ligjit Nr.05/L-028 për tatimin në të ardhura personale, neni 9, në të ardhurat bruto nga pagat përfshihen: bonuset, provizionet, mëditjet dhe format e tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës. Testet tona tregojnë se, shpenzimet e sigurimit shëndetësor të punonjësve të kompanisë regjistronen si shpenzime në baza mujore dhe se vlera totale vjetore e tyre është 42,76€. Megjithatë, këto shpenzime nuk janë përfshirë në të ardhurat bruto të pagat e punëtorëve sipas kërkesave ligjore. Mos përfshirja e shpenzimeve të sigurimit të punëtorëve në të ardhurat bruto, ka ndodhur për shkak të mungesës së njohurive mbi trajtimin e duhur të tyre.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që në të ardhurat personale bruto të përfshihen të gjitha përfitimet e punonjësve sipas kërkesës ligjore në mënyrë që të aplikohet tatimi në vlerën e plotë të ardhurave.	Menaxhmenti ka zbatuar kete te gjetur.	D. Financiar dhe Administrativ	Prill 2022	I zbatuar

<p><b>Çështja A26 - Kompensimi i Aksionarëve Komunal dhe Bordit të Drejtorëve pa vendime përkatëse</b></p>	<p>Ligji për ndërmarrjet publike, neni 20, Kompensimi i Drejtorëve, pika 20.6 ku përcakton se NP-të janë përgjegjëse për pagimin e të gjitha kompensimeve për drejtorët e saj vetëm nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit dhe nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP-ja. Po ashtu, edhe kompensimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve bëhet sipas Vendimit për përcaktimin e kompensimit të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale. Tutje, ky vendim vlen vetëm për aksionarët e zgjedhur nga Kuvendi i Komunës, përderisa kompensimi i aksionarëve të deleguar nga Kryetari i Komunës bëhet me një vendim të veçantë.</p> <p>Bordi i drejtorëve me datë 18.05.2021 ka nxjerrë propozim-vlerësim për stimulimin e performacës vjetore për vitin 2020 të Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Ndërmarrjes, pa aprovimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në vlerë 38,120€. Po ashtu, kompania ka bërë pagesat mujore të anëtarit të tretë të komisionit komunal të deleguar nga Kryetari i Komunës në shumë prej 3,174€, pa një vendim që obligon kompaninë për kompensimin e tij.</p> <p>Sipas menaxhmentit të ndërmarrjes, pagesa e anëtarëve të Komisionit Komunal dhe Bordit të Drejtorëve është bërë me qëllimin më të mirë si rezultat i përkushtimit dhe anagazhimit të tyre.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë vendosur kontrole adekuate të cilat do të parandalonin kompensimet pa vendim të organeve përgjegjëse dhe konform legjislacionit në fuqi.</p>		<p>Bordi</p>		
<p><b>Çështja A27 – Mos përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të Njësies së Auditimit të Brendshëm nga Menaxhmenti</b></p>	<p>Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm 2440, pasi që Drejtori i Auditimit bënë shpërndarjen e rezultateve të auditimit, sipas pajtimeve në raportin final, është përgjegjësi e menaxhmentit të lartë të përmbushë rekomandimet e dhëna apo të pranoj rrezikun e mos marrjes së veprimeve.</p> <p>Gjatë vitit 2021, NJAB kishte dhënë 25 rekomandime për fusha të ndryshme të kontrollit të brendshëm. Prej tyre 14 rekomandime nuk janë zbatuar, 10 janë zbatuar, ndërsa 1 rekomandim është në proces. NJAB në vazhdimësi ju përcjellë njësive të audituara planin për zbatim të rekomandimeve duke kërkuar që të caktojnë personat përgjegjës, afatin kohorë si dhe dëshmi se si janë duke u zbatuar rekomandimet e dhëna, mirëpo menaxhmenti i kompanisë nuk i ka konsideruar me prioritet për ndërmarrjen çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm.</p> <p>Edhe përkundër kërkesës së vazhdueshme nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, menaxhmenti dhe komitetit i auditimit nuk kishin marrë veprime për zbatim të rekomandimeve.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë që menaxhmenti i kompanisë merr veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm me qëllim të përmirësimit të proceseve të qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm.</p>		<p>Bordi Dhe Menaxhmenti</p>		